



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE
MUNICIPALITY OF GJILAN
GILAN BELEDIYESI

Njësia e Prokurimit

Gjilan, me datë: 22.03.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjilanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të dt. 20.03.2024 të parashtruara nga: **OE N.T.P “ Bletaria Egzoni “ nga Gjakova**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“ Furnizim me shoqëri bletesh “ me nr.të prokurimit 651-24-570-1-2-1 dhe me nr.të brendshëm GL 651 24 001 121** nxjerr:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET si e pabazuar** kërkesa për ri-shqyrtim e : **OE N.T.P “ Bletaria Egzoni “ nga Gjakova**, e parashtruar me dt. 20.03.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“ Furnizim me shoqëri bletesh “**, me nr.të prokurimit 651-24-570-1-2-1 dhe me nr.të brendshëm GL 651 24 001 121 kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK e dt. 15.03.2024 të publikuar në platformën e prokurimit elektronik.
- II. **VËRTETOHET** Njoftimit mbi Vendimin e AK i dt. 15.03.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“ Furnizim me shoqëri bletesh “**, me nr.të prokurimit 651-24-570-1-2-1 dhe me nr.të brendshëm GL 651 24 001 121, AK - Kuvendi Komunal Gjilan vendosë të vazhdojë më tutje me procedurën e prokurimit të përcaktuar si në pikën një dhe dy të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET N.T.P “ Bletaria Egzoni “ nga Gjakova**, si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike në adresë <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

N.T.P “ Bletaria Egzoni “ nga Gjakova, si palë e pakënaqur me datën 20.03.2024 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK e dt. 15.03.2024 të publikuar në platformën e

prokurimit elektronik, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull. "Furnizim me shoqëri bletesh", me nr. të prokurimit 651-24-570-1-2-1 dhe me nr. të brendshëm GL 651 24 001 121.

AK – Komuna e Gjilanit konstaton se Kërkesa për Rishqyrtim e OE ankues është ushtruar brenda afatit ligjor në pajtim me nenin 108/ A, paragrafi 3.1 të LPP sipas procedurës paraprake për zgjedhjen e mosmarrëveshjeve dhe si e tillë i përmban elementet e përcaktuara me nenin 60 paragrafu 3 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Në këtë mënyrë Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit të AK - Komuna e Gjilanit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë kërkesë sipas nenit 108/A të LLP –së dhe se nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Në këtë pikpamje Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit të AK-së, me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike në mënyrë objektive dhe ligjore ka shqyrtuar dhe analizuar në detaje tërësin e secilit pretendim ankimor në kontekstin e atakimit nga OE ankues dhe në këtë mënyrë është gjetur se:

- **Pretendimet e OE ankues N.T.P " Bletaria Egzoni " nga Gjakova " janë të pabazuara** sepse Njoftimi mbi Vendimin e AK është i drejtë dhe rrjedhimish i ligjshëm në pajtim me të gjitha dispozitat përkatëse të LPP-së dhe të legjislacionit sekondar të prokurimit publik.
- **Konstatimet e AK-së bazuar në faktet dhe rrethanat e rastit.**

Pretendimi nr.1. Se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar deklaratë dhe as ndonjë dëshmi se me çfarë race të bletëve ka ofertuar, ndërsa tek pyetjet sqaruese njëra ndër pyetjet (nr.15) ka qenë si në vijim: Raca e bletëve a duhet të jetë Apis Millifera apo race tjetër, ndërsa përgjigja ishte Raca e kërkuar e bletëve duhet te jete -:Apis mellifica var. carnica Pollm. Këto pyetje dhe përgjigje normalisht qëjanë pjesë e dosjes së tenderit dhe secili OE është dashur të dëshmojë se raca e bletëve do të jetë Apis mellifica var. carnica Pollm.

Ne kemi ofruar deklaratën për racën e bletëve, ndërsa OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar asnjë deklaratë apo dëshmi, prandaj ky OE është i papërgjegjshëm.

Pretendimi nr.2. Gjithashtu sqarojmë se OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me çmim më të shtrenjtë se sa oferta jonë.

Në procesverbal të hapjes çmimi i OE të rekomanduar për kontratë pa TVSH është 15,000.01 €, kurse me TV SH 17,700.00 €, ndërsa me TV SH edhe tek njoftimi mbi vendimin është 17,700.00 € Ne kemi çmimin në procesverbal të hapjes 15,000.00 € pa TVSH, kurse me TV SH 17,700.00 €, e po ashtu edhe tel' njoftimi mbi vendimin është 17,700.00 €.

Çmimi i OE të rekomanduar për kontratë në procesverbal të hapjes pa TVSH është më i shtrenjtë se sa çmimi i ofruar nga ne, ndërsa kur i shtohet edhe TVSH atëherë përsëri është me çmim më të shtrenjtë se sa oferta jonë. Kur i shtohet TVSH atëherë çmimi i OE të rekomanduar për kontratë 17,700.01 €.

Ndërsa çmimit tonë kur i shtohet TVSI-I-ja rezulton të jetë 17,00.00 €, e që i bie se ne jemi me çmim më të lirë se sa oferta e OE të rekomanduar për kontratë.

Autoriteti kontraktues e ka shpall fitues OE të rekomanduar për kontratë kinse ka çmimin e njëjtë me ofertën tonë dhe me arsyetimin se i njëjti ka ofertuar me kohë përpara neve. Është e vërtetë se ky OE ka

ofertuar para neve me kohë, mirëpo i njëjti ka çmim më të shtrenjtë se sa ofertajonë dhe në këtë rast nuk vjen në shprehje zbatimi i nenit 39.8 i rregullores Nr.001/2022 për prokurim publik.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezultoi se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.



Gjithashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, sepse na ka diskriminuar neve duke mos na shpallur fitues edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë dhe njëkohësisht jemi OE me çmim më të lirë. Paragrafi I i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhejo- diskriminuese edhe do të veprojë në mënyrë transparente.

Në këtë rast nuk është respektuar as neni 6 ekonomikiteti sepse nuk është rekomanduar për kontratë oferta me çmimin më të ulët.

AK-ja është dashur të ketë në konsideratë edhe nenin I të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Lidhur me pohimet e secilit pretendim ankimor të OE ankues N.T.P ' Bletaria Egzoni ' nga Gjakova, në bazë të fakteve, provave dhe dokumenteve relevante të Autoritetit Kontraktues nga njëra anë dhe bazës ligjore të zbatueshme me rastin konkret nga ana tjetër, AK – Komuna e Gjilanit ka vlerësuar si në vijim:

Pretendimet ankimor të lartë cekura janë të pabazuara pasi që: OE i rekomanduar që të shpërblehet me kontratë reth Specifikimet teknike të detyrueshme ka ofruar Deklaratën me shkrim se: Furnizimet do të jenë në pajtim të plotë me specifikimet teknike të parashtruara në këtë Dosje të Tenderit, sipas Aneksit 1, Specifikimet teknike të detyrueshme dhe në përputhshmëri në të gjitha aspektet me vizatimet, sasishtë, modelet mostrat, matjet dhe udhëzimet tjera.



Si dhe AK ka vepruar sipas nenit 39.8 të RRPP, nr.001 " Citoj " : *në rastet kur Autoriteti Kontraktues pranon 2 (dy) apo me shumë oferta të përgjegjshme me çmime të njëjta (identike) nuk vlen votimi i anëtarëve të Komisionit të vlerësimit për përzgjedhjen e OE, por përzgjedhja bëhet sipas kohës së dorëzimit të ofertës (OE i cili e ka dorëzuar ofertën i pari).*

Gjithashtu, Platforma elektronike e-prokurimit e bënë përzgjedhjen automatikisht për ofertën e përgjegjshme i cili ka dorëzuar ofertën i pari.

Sipas procesverbalit të hapjes së ofertave dhe Formularit të paraqitjes së tenderit Çmimi i ofertuar nga ana e OE të rekomanduar është 17,700.00 €.

Sipas RRPP, nr.001 neni 35.8 Për çdo tender, sistemi verifikon integritetin e tenderit (Integriteti i të dhënave në Formularin e Dorëzimit të Tenderit).

35.10 Çmimet në oferta dekriptohen, paraqiten në ekran dhe ruhen në bazën e të dhënave. Çmimet në bazën e të dhënave përdoren për krijimin e procesverbalit të dokumentit të hapjes publike.

Sipas RRPP, nr.001 " Citoj " 17.7 Pjesa C, *Formulari për dorëzimin e ofertës, është pjesa kryesore e tenderit, sepse në këtë pjesë ofertuesi deklaron se ai ka kontrolluar dhe pranon të gjitha kushtet e tenderit dhe dorëzon ofertën e tij financiare.* Pjesa C përbëhet nga:

- Formulari i tenderit
- Lista e çmimeve

Në këtë rast OE i rekomanduar që të shpërblehet me kontratë ka paraqitur çmimin e njëjtë në vlerë totale prej 17,700.00 €, si në Procesverbalin e hapjes, Formularin e tenderit dhe Listën e çmimeve.

Lidhur me pretendimet e juaja se AK nuk ka respektuar kriteret kryesore të dhënjes së kontratës.

Përgjigjia e AK lidhur me këto pretendim është se:

Autoriteti Kontraktues (AK) - ka vepruar në harmoni me Nenin 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës, ku ka rekomanduar ofertën e përgjegjshme me çmimin më të ultë si dhe në harmoni me Nenin 59 të LPP-së, ka bërë ekzaminim, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave, dhe sipas kritereve të përcaktuara në FDT Dosjen e tenderit dhe Njoftimit për Kontratë.

Gjithashtu, Autoriteti Kontraktues (AK) - në harmoni me Nenin 1 Qëllimi, Nenin 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, Nenin 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi ka trajtuar operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë pa diskriminime dhe ka vepruarë në mënyrë transparente.


- Përfundim

Bazuar në të lartëcekurat, AK konsideron se në të gjitha veprimet dhe aktet e AK-së, gjatë këtij procesi të prokurimit se ka vepruar në pajtueshmëri të plotë me të gjitha dispozitat përkatëse ligjore të LPP-së dhe legjislacionit sekondar Rregullores së prokurimit publik të cilat parashohin dhe rregullojnë kushtet dhe kriteret që paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Duke u bazuar në arsyet e dhëna më lart, Autoriteti Kontraktues në kuptim të nenit 108/A në paragrafin 10.1 të LPP-së dhe duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 1.1 pika (b) të lidhur me nenin 62.1 pika (d) të Rregullorës Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur me këtë vendim mund tëparaqesë ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimi të këtij vendimi.

Shqipe Hoxha



Zyrtare përgjegjëse e zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;
Arkivit të Komunës.

BLETARIA TE AHMETI SHPK
VUSHTRRI

DEKLARATË

KUVENDI KOMUNAL- GJILAN

Nr i prokurimit	651-24-570-1-2-1
Nr i brendshëm	GI 651 24 001 121


Titulli: Furnizim me shoqëri bletesh

Deklarat

Deklarojmë në përgjegjësi të plotë se do të përmbahemi të gjitha kushteve të kontratës dhe se jemi në përshtatshmëri të plotë me aneksin 1 të dosjes së tenderit.

Vushtrri
22.02.2024

Bletaria te Ahmet SHPK



¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

Aneksi I SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

SPCIFIKACIONI TEKNIK I SHOQËRIVE TË BLETËVE

Përshkrimi i specifikave:

1. Shoqëritë e bletëve duhet të jenë të shëndosha (pa sëmundje), të forta (në gjeneratë dhe miza), të vendosura në shtëpiza të reja (të përdorura) standardë të tipi LR (njëkatëshe).
2. Dyshemeja e re anti-varo ose klasike (e plotë).
3. Tavani i ri
4. Qatia e re
5. Të ketë 10 korniza standardë me hoje të mira
6. Shoqëritë e bletëve të kenë së paku 6 korniza me gjeneratë të staveve të ndryshme
7. Shoqëritë e bletëve të kenë së paku nga 8 korniza të mbushura me miza (bletë)
8. Shoqëritë e bletëve të kenë mëmën jo më të vjetër se dy vjeqare
9. Të kenë së paku nga 6kg ushqim
10. Të mos jenë agresive
11. Furnizimitë bëhet në periudhën 15 diteve
12. Transportin e bletëve deri te përfituesi e bartë Operatori Ekonomik i shpërblyer me kontratë

Me rastin e furnizimit, të gjitha shoqëritë e bletëve do të kontrollohen nga komisioni profesional i bletarisë dhe nuk do të pranohen shoqëritë e bletëve në të cilat haset çfardo parregullësie.

Operatori Ekonomik të deklarojë me shkrim se i ka lexuar dhe kuptuar mirë specifikat që duhet të plotësojnë shoqëritë e bletëve dhe të zotohet se do të plotësojë të gjitha sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktues.

Deklarata duhet të jetë e nënshkruar nga OE dhe e vulosur.

